

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Furnizim me lëndë radioaktive dhe kite të ftohta për Njësinë e Mjekësisë Berthamore për 36 muaj**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Materiale radioaktive 09343000-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 112,834,650.00** (njëqind e dymbëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtë qind e pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH**, e konvertuar në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të datës 02.05.2024: **1,124,859.44** (një milion e njëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) **Euro pa TVSH**.

**Shumatore e çmimeve për njësi: 545,150.00** (pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**, e konvertuar në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të datës 02.05.2024: **5,434.65** (pesë mijë e katërqind e tridhjetë e katër) **Euro pa TVSH**.

Vlerat janë konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 02.05.2024 me kurs këmbimi 100.31 (njëqind pikë tridhjetë e një) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor **Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

**d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**a)** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**b)** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikimin **ISO 45001:2018** mbi “**Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë**”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Kriteret e percaktuara ne piken **a)** dhe **b)** eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ne te cilen parashikohet se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktuar për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Këto kritere gjejnë mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu këto kritere gjejnë mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së Përgjithshme të Akreditimit, administruar pranë APP me nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe pranë DPA me nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilesise”.

Për sa më sipër, vlerësohet se kriteret e renditura në gërmat ”a” dhe ”b” janë në përputhje gjithashtu me nenin 77 të LPP dhe 40(3) të RrPP, vlerësohen proporcionalë dhe të lidhur me objektin e prokurimit, në mënyrë që të provohet aftësia profesionale e OE për të furnizuar AK me mallrat e kërkuara.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Licencë për veprimtari import/eksport të burimeve radioaktive, nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR).**

ç) Operatori ekonomik duhet të paraqesë **licencë për ruajtjen e përkohshme/për ruajtje dhe trajtim burimesh radioaktive të konsumuara, ose të jetë i pajisur me kontratë me një subjekt i cili zotëron një licencë të tillë për ruajtje të burimeve radioaktive dhe burimeve radioaktive të konsumuara.**

**Argumentimi:** Kriteret e përcaktuara në pikën c) dhe ç) është vendosur në përputhje me relacionin nr. 336/13 prot., datë 03.04.2024 “*Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim me lëndë radioaktive dhe kite të ftohta për Njësinë e Mjekësisë Berthamore” për 36 muaj*”, hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 34, datë 01.02.2024 “*Për ngritjen e grupit të punës për llogaritjen e fondit limit (...)*”, i ndryshuar, si dhe janë miratuar nga anëtarët e njësisë që kanë specializimin përkatës, në përputhje me nenin 77 të LPP, ku përcaktohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe nenin 40(3) të RrPP, ku përcaktohet se ”3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”. Gjithashtu, kjo kërkesë rrjedh edhe nga *lex specialis*, ligji nr. 8025, datë 09.11.1995 ”Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, i cili, ndër të tjera përcakton se: “**Neni 2** Në kuptim të këtij ligji:(...) g) “Licenca” është dokumenti që autorizon mbajtësin e saj të kryejë veprimtari me lëndë radioaktive dhe/ose pajisje rrezatuese. (...); **Neni 4** Të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që kryejnë veprimtaritë e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji, duhet të pajisen me licencë nga autoriteti kompetent. Procedura e pajisjes me licencë përcaktohet në rregulloren përkatëse.”.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e tyre te jete **jo me e vogel se 50 % e vlerës së fondit limit.**

*Shënim\*:* Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10.

Nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

**Argumentimi:** Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162, datë 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **50 % e vlerës së fondit limit\* për të cilat konkurron operatori, eshte nje deshmi e mjaftueshme per te krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operoret Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore të të ardhurave; (*Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 13 pika 2. Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.*).

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose / dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

**Shënim\*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" në pikën 2.10.**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin*



*vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më të vogla se **20 %** e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor QSU “Nënë Tereza” Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

**b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, me anë të së cilës deklaron origjinën dhe vendin prodhues të lëndës radioaktive dhe kiteve të ftohta si dhe që ambalazhimi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

**Argumentimi:** Kriteri i vendosur në germën b) është vendosur nga anetari i NjP qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, si dhe nenin 40/8 të VKM 285/2021 ‘Për

Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', të ndryshuar. Deklarata mbi origjinen e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) është kërkuar në mënyrë që me anë të saj do të bëhet krahasimi i ofertës, artikujve që ofertojnë nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

c) Për të gjithë artikujt e ofruar dhe që janë pjesë e tabelave të pasqyruara në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike /specifikimi i materialeve*), **duhet të paraqiten katalogë teknikë/Skeda teknike/Broshurë teknike/dokument teknik (nga prodhuesi), ku të përfshihet informacion i hollësishëm apo specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull** (*pjesët e katalogut/skedës teknike/broshurë teknike/dokumentit teknik (nga prodhuesi), që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertojnë*) nëse katalogët e paraqitura nuk janë në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehen në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohen. Operatori ekonomik **duhet të markojë në katalogun perkates produktet për të cilat oferton**, sipas numrit rendor të percaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e percaktuar se: [...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së artikujve që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të percaktuara në DST në Shtojcën 5.

ç) **Operatori ekonomik** duhet të paraqesë **oferten teknike** për artikujt e kërkuar, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emërtimi i katalogut të artikullit / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese për produktet.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga anetari i Njesisë së Prokurimit që ka specialitet perkatese në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me **pikën 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" I ndryshuar**, në të cilën është e percaktuar se: 1. *Specifikimet teknike, siç percaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike percaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë*

*përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.. Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me ane të se ciles do të behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformitetit me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.*

**\*Shënim:** KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

### **Shënim për operatorët ekonomikë:**

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t’i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**



Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

### Shtojca 5.

#### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr.	Emertimi i lendes/kitit të ftohtë	Aktiviteti i lendes
1	Gjenerator Mo (tc)-99m (GBq)	20
2	I-131 (mCi)	100
3	I-131(mCi)	20
4	I-131(mCi)	10
5	I-131(mCi)	5
6	MIBI (flakon)	
7	MAG-3 (flakon)	
8	MAA (flakon)	
9	DMSA (flakon)	
10	DTPA (flakon)	
11	MDP (flakon)	

#### SPECIFIKIME TË PËRGJITSHME

- OE duhet të vetëdeklarojë, që përpara nënshkrimit të kontratës së furnizimit apo Marrëveshjes Kuadër, duhet të jetë i pajisur me Licencë për veprimtari import/eksport të burimeve radioaktive, nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.
- OE për veprimtarinë me burime te rrezatimeve jonizuese duhet të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
- OE duhet të jetë i licensuar për ruajtjen e përkohshme/për ruajtje dhe trajtim burimesh radioaktive të konsumuara, ose të jetë i pajisur me kontratë me një subjekt i cili zotëron një licencë të tillë për ruajtje të burimeve radioaktive dhe burimeve radioaktive të konsumuara.
- Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë transportin e lëndës radioaktive dhe kiteve të ftohta nga furnizuesi deri tek vendi i dedikuar për pritjen e lëndës radioaktive, që do të jetë dhoma e nxehtë në Njësinë e Mjekësisë Berthamore diten e

**henë deri në orën 12:00 që është ora e kalibrimit të aktivitetit të kërkuar të lëndës radioaktive.**

- Operatori ekonomik do të jetë përgjegjës për lëndën radioaktive dhe kitet e ftohta deri në momentin e dorëzimit të tyre tek Njësia e Mjekësisë Berthamore, pas verifikimit të sasisë dhe pastërtisë së tyre.
- Transporti nga pika kufitare deri në QSUNT, realizohet nga vetë OE me mjetet e veta ose nëpërmjet IFBZ (Instituti i Fizikës Berthamore të Zbatuar)
- Operatori Ekonomik, duhet të marrë mbarsht mbetjet radioaktive që prodhen nga lënda radioaktive që ai sjell në Njësinë e Mjekësisë Berthamore dhe ti depozitojë ato pranë depove të licensuara për ruajtje të mbetjeve radioaktive të IFBZ.
- Operatori Ekonomik duhet të vej Autoritetit Kontraktor në dipozicion të gjithë dokumentacionin që shoqëron lëndën radioaktive.
- OE përpara çdo importi të rradhës, OE duhet të aplikojë për leje importi pranë ZMR, si dhe duhet të vendos në dispozicion të AK dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin IFBZ kur i kërkohet.
- Burimet radioaktive të destinuara për AK, nuk duhet të transferohen tek subjekte të cilat nuk disponojnë licensën përkatëse për përdorimin, ruajtjen etj.
- OE është përgjegjës për zhdoganimin e burimeve radioaktive dhe koordinimin me Institutin e Fizikës Berthamore të Zbatuar (IFBZ) deri në dorëzimin tek vendi i dedikuar në NJMB pranë AK.
- OE duhet të deklarojë origjinën dhe vëndin prodhues të lëndës radioaktive dhe kiteve të ftohta si dhe që ambalazhimi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Skadencia në ditën e lëvrimit, do të jetë:
  - Për gjeneratorët Mo (tc)-99m, aktiviteti në ditën e hënë, ora 12:00, duhet të jetë 20 (GBq);
  - Për Jodin Radioaktiv, data e skadencës në ditën e dorëzimit do të jetë të paktën dy javë;
  - Për Kitet e Ftohta, data e skadencës, në ditën e lëvrimit, do të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndermjet dates se prodhimit dhe asaj te skadences.

**Specifikime teknike të tjera:**

- Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë transportin e lëndës radioaktive dhe kiteve të ftohta nga furnizuesi deri tek vendi i dedikuar për pritjen e lëndës radioaktive, që do të jetë dhoma e nxehtë në Njësinë e Mjekësisë Berthamore ditën e hënë deri në orën 12:00 që është ora e kalibrimit të aktivitetit të kërkuar të lëndës radioaktive. Çdo moment pas orës 12:00 të ditës së kalibrimit, lënda radioaktive e humbet aktivitet e kërkuar të saj. Operatori ekonomik do të jetë përgjegjës për lëndën radioaktive dhe kitet e ftohta deri në momentin e dorëzimit të tyre tek Njësia e Mjekësisë Berthamore, pas verifikimit të sasisë dhe pastërtisë së tyre. Transporti nga pika kufitare deri në QSUNT, realizohet nga vetë OE me mjetet e veta ose nëpërmjet IFBZ (Instituti i Fizikës Berthamore të Zbatuar).

- Operatori Ekonomik, duhet të marri mbrapsht mbetjet radioaktive që prodhen nga lëndë radioaktive që ai sjell në Njësinë e Mjekësisë Berthamore dhe ti depozitojë ato pranë depove të licensuara për ruajtje të mbetjeve radioaktive të IFBZ.
- Operatori Ekonomik duhet ti vej Autoritetit Kontraktor në dispozicion të gjithë dokumentacionin që shoqëron lëndën radioaktive.
- OE përpara çdo importi të rradhës, OE duhet të aplikojë për leje importi pranë ZMR, si dhe duhet të vendos në dispozicion të AK dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin IFBZ.
- **Shënim: Në rastin e shpalljes fitues të OE, përpara nënshkrimit të kontratës së furnizimit apo Marrëveshjes Kuadër, duhet të jetë i pajisur me Licencë nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për importin e burimeve radioaktive për të tretë.**

**Argumentimi:** Specifikimet teknike janë miratuar nga anëtarët e njesise se prokurimit qe kane specialitetin perkates, bazuar në shkresën nr. 336/3 prot., datë 15.02.2024 të Njësisë së Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore, si dhe shkresës nr. 336/5 prot., datë 19.02.2024 të Shefit të Shëbimit të Endokrinologjisë dhe Mjekësisë Nukleare, te miratuara dhe nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përmes relacionit nr. 336/13 prot., datë 03.04.2024 “*Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim me lëndë radioaktive dhe kite të ftohta për Njësinë e Mjekësisë Berthamore” për 36 muaj*”, hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 34, datë 01.02.2024 “*Për ngritjen e grupit të punës për llogaritjen e fondit limit (...)*”, i ndryshuar, si dhe referuar dokumentacionit mbështetës të këtij relacioni dhe ne perputhje me Ligjin nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, te ndryshuar, dhe VKM-se Nr. 285/2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar.

## Shtojca 6

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Nr.	Emertimi i lendes/kitit të ftohtë	Aktiviteti i lendes	Sasia
1	Gjenerator Mo (tc)-99m (GBq)	20	78
2	I-131 (mCi)	100	144
3	I-131(mCi)	20	720

4	I-131(mCi)	10	720
5	I-131(mCi)	5	720
6	MIBI (flakon)		42
7	MAG-3 (flakon)		90
8	MAA (flakon)		18
9	DMSA (flakon)		90
10	DTPA (flakon)		90
11	MDP (flakon)		348

- **Afati: 36 muaj nga lidhja e marrëveshjes kuadër.**

**AK për mbulimin e nevojave do të lidhë kontratë në çdo kohë, sipas nevojave.**

**Për kontratat e lidhura brenda marrëveshjes kuadër, afatet e lëvrimit do të jenë: Jo më shumë se 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës**

**(Shënim: Ky afat nuk aplikohet për artikujt me numër rendor 1, 2, 3, 4, 5, specifika e të cilëve kërkon furnizim periodik, sipas nevojave të Shërbimit.)**

**Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit** janë vendosur dhe miratuar nga anetaret e njesise se prokurimit qe kane specialitetin perkates, bazuar në shkresën nr. 336/3 prot., datë 15.02.2024 të Njesisë së Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore, si dhe shkresës nr. 336/5 prot., datë 19.02.2024 të Shefit të Shërbimit të Endokrinologjisë dhe Mjekësisë Nukleare, te miratuara dhe nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përmes relacionit nr. 336/13 prot., datë 03.04.2024 “*Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim me lëndë radioaktive dhe kite të ftohta për Njësinë e Mjekësisë Berthamore” për 36 muaj*”, hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 34, datë 01.02.2024 “*Për ngritjen e grupit të punës për llogaritjen e fondit limit (...)*”, i ndryshuar, si dhe referuar dokumentacionit mbështetës të këtij relacioni dhe ne perputhje me Ligjin nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, te ndryshuar, dhe VKM-se Nr. 285/2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar.

**Perllogaritja e fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike, sasi të dhe dokumentacioni mbështetës mbi përcaktimin e nevojave janë bërë në bazë të relacionit me nr. 336/13 prot., datë 03.04.2024.**

### **NJËSIA E PROKURIMIT:**